

LIGJ
Nr. 8580, datë 17.2.2000
PËR PARTITË POLITIKE*

(Ndryshuar me ligjet: nr. 9452, datë 2.2.2006, nr.10 374, datë 10.2.2011, nr.17/2014 dhe nr. 90/2017, datë 22.5.2017)

(I përditësuar, 2017)

Në mbështetje të neneve 9, 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Partitë politike janë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose të interesave të përbashkëta politike, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit.

Neni 2

Partitë politike marrin pjesë në formimin e vullnetit politik të popullit në të gjitha fushat e jetës publike dhe kryesisht nëpërmjet:

- a) ndikimit në krijimin e opinionit publik dhe të edukatës politike;
- b) nxitjes së pjesëmarrjes aktive të shtetasve në jetën politike dhe evidencimin e aftësimit të shtetasve për të marrë përsipër përgjegjësi publike;
- c) pjesëmarrjes në zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore.

Neni 3

Partitë politike shqiptare janë pjesë e një sistemi të lirë e demokratik qeverisës në vend. Krijimi dhe veprimtaria e tyre është e lirë dhe e garantuar nga Kushtetuta.

Neni 4

Partitë politike, në veprimtarinë për arritjen e qëllimeve të tyre, përdorin vetëm mjete dhe metoda demokratike.

Neni 5

Veprimtaria e partive politike mund të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së

* Ligji nr. 8580, datë 17.2.2000 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 6, datë 5 prill 2000.
Ligji nr. 9452, datë 2.2.2006 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 15, datë 2 mars 2006.
Ligji nr.10 374, datë 10.2.2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 14, 2 mars 2011.
Ligj nr. 90/2017, datë 22.5.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 118, datë 23 maj 2017.

Shqipërisë ose në disa njësi të ndarjes administrative territoriale të vendit.

Neni 6

Partive politike u ndalohet të krijojnë organizata me karakter ushtarak ose paraushtarak.

Neni 7

Ndalohet regjistrimi i një partie në rastet kur:

- a) organizimi i saj i brendshëm është në kundërshtim me parimet demokratike dhe, veçanërisht, me parimet vijuese: ndërtimi nga poshtë lart i partisë, zgjedhjet e brendshme demokratike për forumet e partisë, e drejta e shprehjes së mendimit nga çdo anëtar, liria e hyrjes dhe e daljes së tyre nga partia, e drejta e çdo anëtari për të zgjedhur e për t'u zgjedhur;
- b) në dokumentet e themelimit të partisë përmendet shprehimisht ose, nga përmbajtja e tyre, del se ato janë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese që ndalojnë krijimin e partive ose strukturave partiake në fushat e institucionet e parashikuara prej tyre;
- c) partia është krijuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- ç) në dokumentet e themelimit të saj shprehet qëllimi për përdorimin e dhunës për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore;
- d) në dokumentet e themelimit të saj shprehet nxitja dhe përkrahja e urrejtjes racore fetare, krahinore ose etnike;
- dh) mbështetet në metoda totalitariste, si dhe ka karakter të fshehtë;
- e) me të njëjtin emërtim është regjistruar një parti tjetër.

Neni 8

Veprimtaria antikushtetuese e partive politike është e ndaluar.

Konstatimi i veprimtarisë antikushtetuese të partisë politike dhe ndalimi i saj vendoset nga Gjykata Kushtetuese.

KREU II KRIJIMI I PARTIVE POLITIKE

Neni 9

(Ndryshuar fjalia e dytë me ligjin nr.10374, datë 10.2.2011)

Regjistrimi i partive politike bëhet në gjykatën e shkallës së parë të rrethit të Tiranës, e cila mban regjistrin e partive politike. Në regjistrin e partive politike shënohet numri rendor i regjistrit, numri i aktit, numri i vendimit gjyqësor, data e shpalljes, dispozitivi i vendimit, emri i plotë i partisë, inicialet e partisë, stema e partisë, përshkrimi i konfiguracionit të vulës, emri i kryetarit, "numri i anëtarëve themelues shënime për ndryshimin e emrit, konfiguracione të vulës ose të kryetarit të partisë, fshirjes apo mbarimit të veprimtarisë së subjektit, data e bërjes së shënimit, emri, si dhe nënshkrimi i nëpunësit kompetent.

Partia politike njihet si person juridik që nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë.

Deri në datën e regjistrimit, themeluesit e partisë mund të kryejnë veprime që janë të nevojshme për organizimin e saj, siç janë, sidomos, thirrja e zhvillimi i mbledhjes së themeluesve dhe zgjedhja e organeve drejtuese, por nuk mund të kryejnë veprimtari si parti politike.

Neni 10

(Ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr.10374, datë 10.2.2011)

Pasi mbledhja e anëtarëve themelues të partisë politike të ketë miratuar dokumentet e partisë, programin, statutin, si dhe organet drejtuese të saj, duhet të paraqitet në gjykatë kërkesa për

regjistrimin e saj.

Partia politike regjistrohet me kërkesë të nënshkruar nga jo më pak se 3 000 anëtarë themelues. Kërkesa për regjistrimin e një partie politike depozitohet në sekretarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe duhet të përmbajë, për çdo anëtar themelues:

- a) emrin dhe mbiemrin;
- b) numrin personal;
- c) vendbanimin.

Në vendimin e regjistrimit të partisë politike, gjykata tregon edhe numrin e anëtarëve themelues.

Neni 11

(Ndryshuar shkronja "ç" me ligjin nr.10374, datë 10.2.2011)

Në dokumentet për regjistrimin e partisë politike, përcaktohen:

- a) emërtimi dhe selia e partisë;
- b) qëllimet dhe detyrat e saj;
- c) organet udhëheqëse dhe ndërtimi i partisë;
- ç) burimet fillestare të financimit dhe numrin e anëtarëve themelues.

Neni 12

Emri i një partie duhet të jetë i dallueshëm qartë nga ai i partive të tjera ekzistuese. Inicialet dhe emblemat e partive politike nuk duhet të përputhen.

Në zgjedhje përdoren vetëm emrat ose inicialet e partive politike që janë të regjistruara.

Neni 13

Regjistrimi i partisë politike bëhet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për regjistrim dhe të dokumenteve të parashikuara në nenin 10 dhe 11 të këtij ligji.

Në rastin kur dokumentet e partive politike nuk janë të rregullta, gjykata, brenda 20 ditëve e kthen kërkesën për të bërë plotësimet përkatëse.

Neni 14

Dispozitat e këtij ligji për regjistrimin e partive politike janë njëloj të vlefshme për ndryshimet dhe fshirjet në regjistrimet e mëparshme.

Kërkesa për ndryshime në regjistrin e partive politike bëhet nga organi i partisë që ka në kompetencë përfaqësimin e saj ndaj të tretëve.

Neni 15

Vendimi i gjykatës për regjistrimin ose mosregjistrimin e partive politike në regjistrin e partive politike mund të ankimohet në gjykatën e apelit të Tiranës brenda 15 ditëve nga data e shpalljes së vendimit të gjykatës.

KREU III

MJETET FINANCIARE DHE MATERIALE TË PARTIVE

(Shtuar kreu me ligjin nr. 10374, datë 10.2.2011)

Neni 15/1

1. Dispozitat e këtij kreu rregullojnë financimin e partive politike nga burime financiare dhe materiale, publike dhe jopublike, të cilat nuk rregullohen nga dispozitat e Kodit Zgjedhor.

2. Financimi i partive politike udhëhiqet nga parimi i transparencës. Të dhënat për burimet financiare të partive, si dhe për shpenzimet e tyre publikohen kurdoherë.

3. Rregullat e monitorimit, të mbikëqyrjes dhe të auditimit të burimeve financiare e materiale, në çdo rast, duhet të respektojnë barazinë e partive politike përpara ligjit dhe të mos cenojnë të drejtën e krijimit lirisht të tyre.

Neni 15/2

(Shtuar me ligjin nr. 10374, datë 10.2.2011)

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e financimit të partive, sipas rregullave të këtij ligji.

2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bazë dhe për zbatimin e këtij ligji, ka këto kompetenca:

a) harton dhe miraton rregullat për raportimin e financimit, për monitorimin, mbikëqyrjen dhe auditimin financiar të partive politike, si dhe për formatet e standardizuara për raportimin financiar vjetor;

b) miraton formatin e regjistrit të posaçëm të fondeve jopublike të partive politike, si dhe formatin për formën dhe përmbajtjen e deklaratës së dhurimit të fondeve jopublike;

c) mban listën e ekspertëve kontabël të licencuar dhe i cakton me short ata për auditimin e fondeve dhe të shpenzimeve të partive politike;

ç) monitoron, mbikëqyr dhe auditon financimin e partive politike, nëpërmjet kontrollit të dokumentacionit financiar e të llogarive kontabël të partive politike, të subjekteve të lidhura, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me partitë politike apo që ndodhen nën kontrollin e tyre;

d) vendos sanksione kur konstaton shkelje të dispozitave të këtij ligji;

dh) harton programe ndërgjegjësuese dhe organizon trajnime për financimin e partive politike dhe të subjekteve të përfshira në këtë proces, sipas dispozitave të këtij ligji;

e) përcakton masën e fondit publik që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore, në përputhje me këtë ligj;

ë) nxjerr akte nënligjore në bazë dhe për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

Neni 16

Partitë politike janë person juridik. Ato kanë pasuri për kryerjen e veprimtarisë së tyre. Partitë politike kanë mjetet e tyre të propagandës, si dhe instituiconet përkatëse realizuese të tyre.

Neni 17

(Ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.2.2011)

Burimet financiare dhe materiale të partive politike përbëhen nga kuotat e anëtarësisë, nga fondet publike, duke përfshirë edhe ndihmën financiare në masën e caktuar në Buxhetin e Shtetit të miratuar me ligj nga Kuvendi, fondet jopublike, të cilat janë dhurimet financiare, dhurimet në natyrë, shërbimet, sponsorizimet, kreditë apo garancitë e ndryshme, si edhe çdo transaksion tjetër financiar.

Neni 18

(Shfuqizuar me ligjin nr. 10374, datë 10.2.2011)

Neni 19

(Ndryshuar me ligjin nr.9452, datë 2.2.2006, nr. 10374, datë 10.2.2011, ndryshuar shkronja "b" me ligjin nr. 17/2014)

1. Çdo vit në Buxhetin e Shtetit përcaktohet një fond që shërben si ndihmë financiare publike për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike. Ndhimja financiare e parashikuar në Buxhetin e Shtetit në vitet jozgjedhore, si rregull, nuk mund të jetë më e vogël se ndihma e parashikuar në vitin paraardhës.

2. Ky fond ndahet sipas rregullave të mëposhtme:

a) 70 për qind, sipas numrit të deputetëve të fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare. Çdo parti parlamentare përfiton ndihmë financiare në përputhje me numrin e deputetëve që ka fituar në bazë të sistemit zgjedhor të parashikuar në Kodin Zgjedhor;

b) 20 për qind, në mënyrë të barabartë, ndërmjet partive parlamentare dhe partive që kanë marrë mbi

10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare.

c) 10 për qind, sipas përqindjes së fituar ndërmjet partive politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe kanë fituar mbi 1 për qind të votave në shkallë vendi.

Pjesa që mbetet pa u shpërndarë nga 10-përqindëshi i shtohet fondit prej 70 për qind dhe u ndahet partive parlamentare.

3. Masa konkrete e fondit publik, që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore, në përputhje me këtë ligj, përcaktohet me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky vendim u njoftohet partive politike përfituese dhe Ministrisë së Financave.

4. Ndihma financiare vjetore, në çdo rast, jepet vetëm nëse partia politike ka dorëzuar, paraprakisht, raportin financiar të vitit paraardhës, sipas rregullave të përcaktuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Mosdorëzimi i këtij raporti përbën shkak për përjashtimin e partisë politike nga përfitimi i ndihmës financiare vjetore.

5. Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që përcakton masën konkrete të fondit publik për çdo parti politike, mund të ankimohet në gjykatë, në përputhje me rregullat për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 20

Ndalohet krijimi i personave juridikë tregtarë e jotregtarë, që ushtrojnë veprimtari me qëllim fitimi, nga partitë politike apo nëpërmjet të tretëve.

Partitë politike mund t'i përdorin pasuritë e mjediset e tyre për veprimtari ekonomiko-shoqërore të karakterit të botimeve, shtypshkrimeve, shërbimeve apo dhënies me qera, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 21

Ndalohet ndihma financiare dhe materiale nga qeveri dhe nga ente publike ose private të huaja, si dhe nga ente vendase publike ose me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror.

Lejohen dhuratat dhe ndihmat që vijnë nga parti ose bashkime ndërkombëtare partish, nga organizata e fondacione politike, vendase e të huaja, si dhe nga individë, persona fizikë e juridikë privatë vendas.

Neni 22

(Ndryshuar me ligjin nr.10374, datë 10.2.2011)

Shteti lehtëson veprimtarinë e partive politike. Lehtësimi nga shteti i veprimtarisë së partive politike përfshin fushat si vijon:

a) Partitë kanë të drejtë të përdorin pa shpërblim mjetet e informimit masiv publik në rast fushatash elektorale dhe referendumesh.

b) partitë parlamentare pajisen me ndërtesë për selinë e tyre qendrore dhe zyra vendore.

Këtë të drejtë e ka edhe partia politike, mesatarja e votave të së cilës në tri zgjedhjet e fundit parlamentare ka qenë mbi 1 për qind në shkallë vendi.

c) nëse partia politike është pajisur me ndërtesë me kontratë huapërdorjeje, sipas këtij ligji, por nuk plotëson kushtet e parashikuara në shkronjën "b" të këtij neni, atëherë ka të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë për ndërtesën, për ta përdorur vetëm për selinë apo zyrat e saj vendore. Rregulla më të hollësishme përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Brendshëm.

Neni 22/1

(Shtuar me ligjin nr.10374, datë 10.2.2011)

1. Kërkesa për pajisje me ndërtesë, sipas shkronjës "b" të nenit 22, i paraqitet Ministrit të Brendshëm, për pronat shtetërore, në administrim të pushtetit qendror, dhe kryetarit të bashkisë, për pronat që janë pronësi ose në përdorim të pushtetit vendor, të cilët marrin të gjitha masat e nevojshme për pajisjen e partisë parlamentare me ndërtesë.

2. Kur gjenden ndërtesa të lira, sipas rastit, Ministri i Brendshëm ose kryetari i bashkisë lidh kontratën e huapërdorjes, sipas Kodit Civil, me partinë politike që ka të drejtën e ndërtesës, sipas shkronjës "b" të nenit 22. Kur nuk gjenden ndërtesa të lira, shteti merr përsipër pagesën e qirasë së selisë qendrore dhe të zyrave vendore të partisë politike. Kontrata e huapërdorjes ose pagimi i qirasë, sipas këtij neni, për

partitë politike zgjat për aq kohë sa partia politike plotëson kushtet e parashikuara në shkronjën “b” të nenit 22.

3. Rregulla më të hollësishme për llojin e dokumenteve, për procedurën administrative të shqyrtimit të kërkesës, mënyrën e pagesës, numrin e ndërtesave për zyrat vendore dhe për kufijtë maksimalë të qirasë përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Financave.

Neni 23

(shfuqizuar pjesërisht me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 33, datë 9.5.2001 dhe ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.2.2011)

1. Partitë politike dorëzojnë raportet financiare një herë në vit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të cilat duhet të përmbajnë informacion të hollësishëm për:

a) burimet e financimit në bazë të formatit të standardizuar, të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;

b) shpenzimet në bazë të formatit të standardizuar, të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;

c) subjektet e lidhura, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me partitë politike apo që kontrollohen prej tyre, të cilat deklarohen nga vetë partia politike.

2. Partitë politike dorëzojnë raportin vjetor financiar, së bashku me raportin e auditimit, të kryer nga ekspertë kontabël të licencuar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

3. Dorëzimi i raportit financiar vjetor bëhet nga personi përgjegjës për financat në partinë politike ose personi i përcaktuar sipas statutit të partisë politike, brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

4. Gjatë vitit zgjedhor, raportet financiare të partisë duhet të dorëzohen së bashku me raportin financiar të fushatës zgjedhore.

5. Raporti financiar vjetor, raporti i ekspertëve kontabël të licencuar, raporti financiar i fushatës zgjedhore dhe raporti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve publikohen në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve jo më vonë se 30 ditë nga koha e dorëzimit të tyre prej partisë politike.”.

Neni 23/1

(Shtuar me ligjin nr.10374, datë 10.2.2011)

1. Çdo parti politike duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, sipas formatit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shumën e fondeve të përfituara nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit. Në çdo rast, dhuruesi, në kohën e dhurimit, nënshkruan detyrimisht një deklaratë dhurimi, sipas formatit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Lista e personave, që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse, duhet të bëhen kurdoherë publike.

2. Dhurimi i fondeve jopublike, me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë, duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme, të hapur në një bankë nga partia politike. Personi përgjegjës për financat në partinë politike, brenda tre muajve nga krijimi i partisë politike, deklaron pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve numrin e llogarisë bankare, të hapur për këtë qëllim. Numri i llogarisë bankare për çdo subjekt politik publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Ndalohet përfitimi i fondeve jopublike, kryer nga subjekte që nuk deklarojnë identitetin e tyre apo identiteti i të cilave është i papërcaktuar qartë nga partia politike përfituese e fondit jopublik.

4. Çdo shpenzim i kryer nga partia politike kryhet dhe dokumentohet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi.

Neni 23/2

(Shtuar me ligjin nr. 10374, datë 10.2.2011)

1. Në listën e ekspertëve kontabël të licencuar, që KQZ-ja mban në zbatim të këtij ligji, përfshihen të gjithë ekspertët kontabël të licencuar me eksperiencë, që e ushtrojnë këtë profesion më shumë se pesë vjetët e fundit, të cilët aplikojnë.

2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve cakton me short një apo më shumë ekspertë kontabël të licencuar nga lista për të kryer auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik nga

partia politike. Caktimi bëhet brenda 45 ditëve nga data e regjistrimit të partisë politike dhe në fillim të çdo viti kalendarik. Raporti i auditimit paraqitet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve brenda afatit të përcaktuar prej këtij komisioni në vendimin e caktimit të ekspertëve.

3. Partitë politike duhet të vënë në dispozicion të ekspertit të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çdo informacion, dokument apo të dhënë, që kanë të bëjnë me financimin dhe shpenzimet e kryera gjatë vitit kalendarik, sipas këtij ligji.

4. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund të bëjë verifikime të të dhënave të raportit, nëpërmjet pyetjes së personave dhe subjekteve të ndryshme, këqyrjes së dokumenteve që lidhen me këtë çështje, pranë zyrave përkatëse të partive politike që kanë paraqitur raportin, si dhe marrjes së çdo informacioni nga bankat apo persona të tretë. Personat fizikë dhe juridikë janë të detyruar të japin ndihmesën e tyre për zhvillimin normal të procedurës së verifikimit.

5. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve publikon raportet e auditimit për partitë politike brenda 30 ditëve nga koha e paraqitjes së raportit ose, sipas rastit, nga koha e mbylljes së procedurës së verifikimit.

6. Mosrespektimi i rregullave të përcaktuara në këtë ligj nga partitë politike apo dhuruesit, në rast se nuk përbën vepër penale, është kundërvajtje administrative dhe dënohet sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 23/3

(Shtuar me ligjin nr. 10374, datë 10.2.2011)

1. Eksperti kontabël nuk mund të auditojë të njëjtën parti politike për dy vjet radhazi.

2. Shpenzimet e nevojshme për auditimin e partive politike mbulohen nga vetë partitë politike, të cilat transferojnë fondet e nevojshme, për këtë qëllim, në llogarinë bankare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Rregullat e hollësishme për realizimin e këtij procesi përcaktohen me udhëzim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 23/4

(Shtuar me ligjin nr.10374, datë 10.2.2011)

1. Shkelja e dispozitave për financimin e partive politike nga ana e personit përgjegjës për financat në partinë politike apo e personit përgjegjës sipas statutit të saj dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

2. Shkelja e detyrimit për bashkëpunim me ekspertin kontabël të licencuar, të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nga ana e partisë politike, dënohet me gjobë nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë.

3. Refuzimi për të bërë transparent burimet e financimit të partisë politike apo për të lejuar ushtrimin e kontrollit nga ana e ekspertit kontabël të licencuar a të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dënohet me gjobë nga 2 000 000 deri në 5 000 000 lekë ose/dhe me pezullimin deri në 5 vjet të financimit publik për partinë politike.

4. Shkelja e afatit të dorëzimit të raportit financiar në kohën e duhur apo paraqitja e raporteve në shkelje të formateve të standardizuara, të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

5. Fondet jopublike të përfituara nga partia politike, kur identiteti i dhuruesit nuk njihet apo nuk është i përcaktuar qartë, kalojnë për llogari të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

6. Pranimi i fondeve jopublike, me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë dhe kur transaksioni nuk është kryer nëpërmjet llogarisë bankare dënohet me gjobë në masën 30 për qind të shumës së dhuruar.

Neni 24

(Ndryshuar me ligjin nr.10374, datë 10.2.2011)

Në rastet kur një parti politike nuk paguan detyrimet që rrjedhin nga tituj ekzekutivë apo nga akte administrative të ekzekutueshme, atëherë shuma përkatëse i mbahet nga buxheti shtetëror vjetor, që parashikohet për ndihmë financiare të partisë përkatëse.

KREU III/1
MJETET FINANCIARE DHE SHPENZIMET E PARTIVE POLITIKE GJATË FUSHATËS
ZGJEDHORE
(shtuar kreu me ligjin nr. 90/2017, datë 22.5.2017)

Neni 24/1

Financimi i fushatës zgjedhore

1. Burimet e vetme të lejuara të financimit të fushatës zgjedhore për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore janë ato të parashikuara në nenin 87/1 të Kodit Zgjedhor.

2. Ndalohet financimi i fushatave zgjedhore nga fonde, dhurata apo shërbime pa kundërshtëpërblim, të dhëna nga persona fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, jashtë rasteve dhe rregullave të parashikuara nga Kodi Zgjedhor. Shkelja e këtij ndalimi sjell përgjegjësi ligjore për personin përgjegjës për financat në atë parti politike, si dhe për personin fizik ose juridik, vendas apo të huaj.

3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcakton rregullat e detajuara për monitorimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore të partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, për të verifikuar respektimin e ndalimit të parashikuar në pikën 2, të këtij neni, si dhe mënyrën e shpenzimit të fondit financiar të përfutur nga partia politike. Buxheti për zgjedhjet duhet të parashikojë edhe fondin e nevojshëm për auditimin e subjekteve zgjedhore, si dhe për monitorimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore.

Neni 24/2

Kufizimi dhe përcaktimi i shpenzimeve të domosdoshme për fushatën zgjedhore

1. Çdo parti politike, që merr pjesë në zgjedhje, nuk mund të tejkalojë si shpenzim për fushatën fondin financiar që përcaktohet në pikën 3, të nenit 90, të Kodit Zgjedhor.

2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me fondin maksimal të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, përcakton maksimumin e shpenzimeve për çdo fushatë zgjedhore, nisur nga gjendja e përgjithshme ekonomike në vend, numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar në listën e zgjedhësve, aktivitetet, shërbimet dhe materialet e nevojshme për realizimin e një fushate zgjedhore.

3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miraton me udhëzim mënyrën e përlllogaritjes së kostos financiare të çdo aktiviteti, shërbimi apo materiali që do të përdoret për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore.

4. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcakton me udhëzim llojet dhe numrin e aktiviteteve, veprimtarive, shërbimeve dhe materialeve të lejuara për t'u përdorur nga një parti politike gjatë fushës zgjedhore.

5. Në çdo rast, është e ndaluar përdorimi i materialeve propagandistike, përfshirë flamuj dhe postera të çdo lloji apo madhësie, në një distancë më të madhe se 5 m larg zyrës elektorale të subjektit zgjedhor apo kandidatit.

6. Ndalohet transmetimi i reklamave të prodhuara, financuara apo paguara nga institucionet shtetërore apo çdo ent tjetër shtetëror apo publik, për periudhën tre muaj përpara datës së zgjedhjeve, me përjashtim të atyre që shërbejnë për informimin e zgjedhësve, sipas përcaktimeve ligjore.

7. Mosrespektimi i rregullave të parashikuara në këtë nen, përveç parashikimeve në Kodin Penal, përbën kundërvajtje administrative dhe passjell dënimin nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të personit përgjegjës për financat, përkatësisht me gjobë nga 1 000 000 deri në 3 000 000 lekë.

Neni 24/3

Dokumentimi i shpenzimeve

1. Partitë politike janë të detyruara të dokumentojnë në mënyrë të saktë dhe të plotë, sipas rregullave të legjisllacionit në fuqi, të gjithë shpenzimet e kryera dhe mënyrën e përdorimit të fondeve gjatë fushatës zgjedhore. Të gjithë personat përgjegjës për financat në një parti politike trajnohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për mbajtjen, administrimin, raportimin dhe ruajtjen e

dokumentacionit dhe të dhënave sipas këtij neni.

2. Partia politike dorëzon në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kopje të plotë të dokumentacionit për çdo pagesë të kryer gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve, çdo parti politike që është regjistruar në zgjedhje, duhet të bëjë publik dhe të dorëzojë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve një raport për deklarimin financiar të fushatës, duke përfshirë të gjitha degët dhe pjesët e veta përbërëse. Raporti përmban në mënyrë të saktë:

a) të ardhurat e përfituara apo që ka në gjendje partia politike, duke përfshirë burimin dhe datën e përfitimit, për periudhën nga caktimi i datës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve;

b) të gjitha shpenzimet e kryera për periudhën nga caktimi i datës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve, duke detajuar çdo shpenzim që i është bërë fondit financiar të dhënë për shpenzimet e fushatës zgjedhore;

c) bilancin e pasurive dhe detyrimeve që ka partia politike, për periudhën nga data e caktimit të datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve.

3. Çdo parti politike pjesëmarrëse në zgjedhje i mban dhe ruan në arkivat e tyre, për një periudhë 7 (shtatë) vjeçare, dokumentacionin e plotë dhe të detajuar të gjendjes financiare të saj dhe të gjitha degëve për periudhën e mbuluar nga raporti, duke përfshirë:

a) librat e mbajtjes së llogarive, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ku evidentohen të gjitha të ardhurat sipas burimit, shumës, duke e identifikuar mënyrën se si është kryer pagesa, si dhe të gjitha pagesat e kryera ndaj personave të tretë, qëllimi i pagesës dhe mënyra se si është kryer pagesa;

b) dokumentacion të saktë për të gjitha shpenzimet e kryera;

c) gjendjen dhe lëvizjet në llogaritë bankare të saj;

ç) dokumentacionin e plotë të pasurive të paluajtshme në pronësi ose posedim të partisë politike, si dhe çdo kontratë të lidhur për huapërdorje, qira, porosi, apo shitje, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme;

4. Në rast se shuma e përfituar nga partia politike, sipas Kodit Zgjedhor, është më e madhe se shuma e dokumentuar si e shpenzuar për financimin e fushatës zgjedhore, partia është e detyruar të kthejë diferencën e përfituar në KQZ.

5. Partia, e cila nuk kthen fondet përkatëse, sipas pikës 4, të këtij neni, brenda 90 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve, humbet të drejtën e financimeve të tjera nga fondet publike për një periudhë kohe jo më pak se 5 vjet, si dhe nuk regjistrohet si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e radhës, pavarësisht llojit të tyre, as vetëm dhe as si pjesëtare e ndonjë koalicioni.

Neni 24/4

Monitorimi i shpenzimeve të fushatës zgjedhore

1. Jo më vonë se dita e fillimit të fushatës zgjedhore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve emëron me short një numër të mjaftueshëm ekspertësh financiarë, për të kryer monitorimin e fushatës zgjedhore të partive politike, duke përfshirë aktivitetet, veprimtaritë dhe materialet e përdorura prej tyre gjatë fushatës zgjedhore.

2. Raporti i monitorimit i paraqitet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve brenda afatit të përcaktuar në vendimin e emërimit, por në çdo rast jo më vonë se 4 muaj nga data e shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve. Raporti detajon në mënyrë të plotë të gjitha aktivitetet, veprimtaritë dhe materialet që ka përdorur partia politike gjatë fushatës zgjedhore.

3. Ekspertët financiarë kanë të drejtë që të kërkojnë dhe verifikojnë edhe transaksionet financiare të kryera për periudhën 3 muaj përpara dhe pas datës së zgjedhjeve, nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim evidentimin e transaksioneve të pajustificuara dhe që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore të një ose disa partive politike.

4. Me kërkesë të ekspertit financiar, të përcjellë nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, bankat e nivelit të dytë dhe subjektet e tjera që ushtrojnë aktivitete bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, janë të detyruara të japin informacion mbi depozitat, llogaritë dhe transaksionet e kryera gjatë periudhës së monitorimit. Mbledhja, përpunimi dhe administrimi i të dhënave, sipas këtij neni, u nënshtrohet rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale. Ato bëhen publike vetëm nëse vërtetohet se janë përdorur për financim të paligjshëm të një

partie politike dhe në këtë rast Komisioni Qendror i Zgjedhjeve paraqet kallëzim penal në organin e prokurorisë.

5. Procedurat, kriteret e përzgjedhjes së listës paraprake dhe emërimit të ekspertëve financiarë, si dhe mënyra e ushtrimit të veprimtarisë nga ana e tyre, përcaktohen me udhëzim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 24/5

Reduktimi i shpenzimeve të partive politike për reklama politike

1. Përfundimisht përcaktimeve të bëra në Kodin Zgjedhor, gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e Kuvendit të vitit 2017, radiot dhe televizionet private kombëtare, vendore apo satelitore, detyrohen që të vendosin në dispozicion falas për subjektet zgjedhore për reklama politike, respektivisht vetëm 90 minuta për partinë më të madhe të shumicës parlamentare dhe partinë më të madhe të pakicës parlamentare, 45 minuta për partitë e tjera parlamentare dhe 10 minuta për partitë joparlamentare. Partitë politike dhe çdo subjekt tjetër e ka të ndaluar bërjen e reklamave politike kundrejt pagesës gjatë fushatës zgjedhore. Kostoja për vënien e kohës në dispozicion falas subjekteve zgjedhore llogaritet si shpenzim i plotë i zbritshëm për efekte tatimore. Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Ministri i Financave të nxjerrin udhëzimin përkatës.

2. Në rast shkeljeje të detyrimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, apo transmetimit të reklamave politike kundrejt pagesës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gjosit operatorin radioteleviziv vendor apo satelitor me 4 000 000 lekë, operatorin radioteleviziv kombëtar me 8 000 000 lekë, dhe partinë politike me 3 000 000. Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga zyra e përmbarimit gjyqësor. Ankimi ndaj vendimit nuk pezullon ekzekutimin e tij. Në rast shkeljeje, KQZ-ja urdhëron Autoritetin e Mediave Audiovizive të bëjë bllokimin e transmetimit të operatorit radioteleviziv për 48 orë. Bllokimi vendoset jo më vonë se ora 18⁰⁰ e ditës pasardhëse.

3. Monitorimi i zbatimit të rregullave të parashikuara në këtë nen, bëhet nga Bordi i Monitorimit të Medias, i cili njofton brenda ditës Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në rast se vlerëson shkelje të detyrimeve të parashikuara në këtë ligj. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendos sanksionet sipas pikës 2 brenda 24 orëve, nga momenti i njoftimit nga Bordi i Monitorimit të Medias, apo kërkesës së ndonjë subjekti zgjedhor.

KREU IV NDARJA E PARTIVE POLITIKE

Neni 25

Në rastin e ndarjes së partisë politike me marrëveshje, ndërmjet palëve vendoset për përkatësinë e emrit, të simbolit, të flamurit të partisë dhe të pasurisë.

Kur nuk ka marrëveshje midis palëve, kjo bëhet me vendim gjykatë.

KREU V SHPËRNDARJA E PARTIVE POLITIKE

Neni 26

Partia politike shpërndahe:

- a) kur shkrihet ose bashkohet me parti të tjera;
- b) kur ndahet në dy ose më shumë parti të tjera me emër të ri;
- c) kur vetëshpërndahe në përputhje me normat e statutit të saj;
- ç) kur numri i anëtarëve të partisë ka mbërritur nën numrin minimal të caktuar me statut ose sipas këtij ligji;
- d) kur ndalohet veprimtaria e saj me vendim të organit kompetent.

Vendimi për shpërndarjen e partisë politike depozitohet në gjykatën e shkallës së parë të rrethit të Tiranës. Kjo gjykatë vendos çregjistrimin e partisë dhe procedurat përkatëse për likuidimin e saj.

KREU VI DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 27

Brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria e Drejtësisë i kalon gjykatës së shkallës së parë të Rrethit të Tiranës, dokumentet e partive politike të regjistruara prej saj deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Gjykata e shkallës së parë të Rrethit të Tiranës bën kalimin në regjistrin e saj të veçantë për partitë politike brenda 90 ditëve nga marrja në disponim e dokumentacionit.

Neni 28

Ligji nr.7502, datë 25.7.1991 “Për partitë politike” dhe çdo dispozitë që vjen në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohet.

Dispozitë kalimtare

(E parashikuar me ligjin nr. 10374, datë 10.2.2011)

1. Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, kryen:

a) inventarizimin e pronave shtetërore të paluajtshme, që u janë dhënë partive politike;

b) identifikimin e marrëdhënies juridike, të krijuar ndërmjet shtetit dhe partisë politike për pronën që i është dhënë partisë politike.

2. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit të këtyre pronave, Ministri i Brendshëm njofton partinë politike që, brenda një afati prej 30 ditësh:

a) të lirojë dhe të dorëzojë këto prona, në rast se kushti i parashikuar në shkronjën “b” të nenit 22 është zgjidhur; ose

b) të lidhë kontratën e qirasë, sipas shkronjës “c” të nenit 22.

3. E njëjta procedurë zbatohet edhe nga organet drejtuese të njësive të pushtetit vendor për pronat shtetërore që u janë transferuar në pronësi.

4. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministri i Financave, në rast se kushti i parashikuar në shkronjën “b” të nenit 22 është zgjidhur, urdhëron ndërprerjen e pagesës së qirasë të partive politike, nëse ka, nga fondet e Buxhetit të Shtetit.

5. Personi përgjegjës për financat në partinë politike ose personi i caktuar në statutin e saj, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, deklaron pranë KQZ-së numrin e llogarisë bankare të hapur për dhurimin e fondeve jopublike, me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë, në favor të partisë politike.

6. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, brenda 45 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, harton listën paraprake dhe cakton, me short, një apo më shumë ekspertë kontabël të licencuar, për të kryer auditimin e fondeve, të përfituara e të shpenzuara gjatë vitit kalendarik nga partitë politike, duke përcaktuar edhe afatin për paraqitjen e raportit të auditimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Dispozitë kalimtare

(E parashikuar me ligjin nr. 90, datë 22.5.2017)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miraton aktet nënligjore sipas këtij ligji, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit. Rregullat e parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, i njoftohen menjëherë të gjitha partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore. Personat përgjegjës për financat, si dhe ekspertët financiarë të emëruar për monitorimin e shpenzimeve trajnohen nga ekspertët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve brenda 3 ditëve nga miratimi i akteve nënligjore.

Subjektet zgjedhore apo kandidatët marrin masat brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, për të përshtatur veprimtarinë e tyre politike apo shpenzimet e fushatës zgjedhore, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj.

Neni 29

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2566, datë 28.2.2000, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.